



IOM International Organization for Migration  
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

## **PAKETË INFORMUESE PËR MALTËN**

### **1. Informacion bazë**

Kryeqyteti:	Valeta
Popullsia:	403,000
Sipërfaqja:	316 km <sup>2</sup>
Gjuha:	Malteze
Monedha:	Euro (EUR)
Niveli i papunësisë:	5,8%

### **2. Kushtet e përgjithshme të hyrjes dhe informacion për vizat**

Për të hyrë në Maltë ju duhet të keni:

1. Një pasaportë të vlefshme;
2. Prova që i keni mjetet për të përballuar jetesën;
3. Prova për strehimin.

Vizat përpunohen nga Autoritetet e Imigracionit në Policinë Malteze. Më pas, vizat lëshohen nga autoritetet konsullore në vendet e origjinës së migrantëve, nëse kërkesa është paraqitur pranë njëres prej këtyre zyrave.

Një shtetas i huaj që hyn në Maltë duhet të ketë një dokument të vlefshëm udhëtimi, si dhe një vizë ose leje qëndrimi.

#### **Llojet e vizave**

Autoritetet malteze mund të lëshojnë tre lloje vizash. Lloji i vizës tregohet në një seksion të veçantë të vizës pullë dhe shënohet me germa A, B, C.

#### **Viza tranzit aeroportuale - A**

Kjo vizë u mundëson shtetasve të cilëve u nevojitet vizë, qëndrimin në zonën tranzit ndërkombëtare të një aeroporti ndërkohë që presin fluturimin lidhës, por nuk i lejon të hyjnë në vend.

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Ndërtimi i Kapaciteteve, Informacion dhe Ndërgjegjësim për Promovimin e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme/Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra



Federal Office  
for Migration  
and Refugees



GOVERNMENT  
OF LIECHTENSTEIN

Shënim: Shtetasit nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia nuk kanë nevojë për vizë tranzit aeroportuale kur kalojnë në Maltë.

### Viza tranzit - B

Kjo vizë i lejon një të huaji, që udhëton nga një shtet në një tjetër, të kalojë tranzit nëpër territorin e Shengenit. Viza tranzit mund të lëshohet vetëm nëse i huaji vërteton se ai/ajo lejohet të hyjë në vendin që ka destinacion pas qëndrimit në territorin e Shengenit. Një vizë tranzit mund të lëshohet për një ose dy kalime dhe, në raste të veçanta, shumë kalime, me kusht që asnjë kalim nëpër territor të mos e kalojë numrin e ditëve të përcaktuar në seksionin e kohëzgjatjes së qëndrimit të vizës pullë. Me ligj, viza tranzit nuk mund të jetë më e gjatë se 5 ditë.

### Viza afatshkurtër - C

Kjo vizë i mundëson të huajit hyrjen dhe qëndrimin në territorin e Shengenit për qëllime turizmi, tregtie, personale, vizite ose për ndonjë qëllim tjetër të ngjashëm. Një vizë afatshkurtër mund të lëshohet për një, dy ose shumë hyrje në vend, nga të cilat as një qëndrim i vetëm i pandërprerë, as kohëzgjatja e përgjithshme e numrit të ditëve të njëpasnjëshme, nuk i kalon 90 ditët brenda një periudhe prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e hyrjes së parë.

Mbi bazën e Marrëveshjeve për Lehtësimin e Vizave dhe për Ripranimin ndërmjet BE-së dhe **Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë**, shtetasit e këtyre vendeve vazhdojnë të kenë nevojë për vizë Shengen C për të hyrë në Maltë; megjithatë, ata përfitojnë nga një tarifë e reduktuar për lëshimin e vizës (35 Euro dhe jo 60 Euro). Shumë kategori aplikantësh (pjesëtarë familjesh të shtetasve me qëndrim të ligjshëm, studentët dhe pensionistët, gazetarët, etj.) tani mund të përfitojnë viza pa pagesë. Për kategori të caktuara personash, psh. tregtarë, studentë dhe gazetarë, kriteret për dokumente janë më të thjeshtuara. Disa kategorive të personave që udhëtojnë shpesh (duke përfshirë tregtarë, gazetarë, studentë, përfaqësues të shoqërisë civile) do t'u jepen viza me shumë hyrje që janë të vlefshme për periudha të gjata, ndërsa personat me pasaporta diplomatike do të përjashtohen nga detyrimi për vizë.

Për detaje, ju lutemi të shikoni në:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0085:0095:EN:PDF> (për Shqipërinë)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0097:0107:EN:PDF> (për Bosnje-Hercegovinën)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0125:0135:EN:PDF> për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0137:0147:EN:PDF> për Serbinë

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0109:0119:EN:PDF> për Malin e Zi

### **Ku mund të aplikoj?**

Nëse ekziston një Ambasadë/Komisioner i Lartë ose Konsullatë Malteze, ju duhet të kontaktoni me Konsullin e Nderit i cili, megjithëse nuk mund t'ju nxjerrë vizë, mund t'ju ndihmojë për procedurat. Për më tepër, ju mund të kërkon vizë duke shkarkuar Formularin për Vizë (<http://www.mfa.gov.mt/images/files/file/Visa%20Application%20French.pdf>) dhe duke e dërguar atë me faks, bashkë me një kopje të pasaportës dhe dokumente të tjera të nevojshme tek Komisionieri i Policisë në Maltë. Në rast miratimi, ju duhet ta paraqisni këtë letër pranë linjës ajrore përpara se të niseni për Maltë. Viza përkatëse do t'ju lëshohet pas mbërritjes në aeroport.

Një listë e misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore malteze ku mund ta dorëzoni aplikimin tuaj për vizë:

#### SHQIPËRI (*Tiranë*)

Embassy of Austria (Ambasada e Austrisë)

Rruga Frederik Shiroka Nr. 3, Tirana

Tel: (+355/4) 274 855 / 856

Fax: (+355/4) 233 140

#### BOSNJE-HERCEGOVINA (*Sarajevë*)

Embassy of Austria (Ambasada e Austrisë)

Dzidzikovac 7, BiH-71000 Sarajevo

Tel: (+387/33) 279 400 / 419

Fax: (+387/33) 668 339

MALI I ZI (*Podgoricë*)  
General Consulate of Italy (Konsullata e Përgjithshme e Italisë)  
Ulica Djordja Vasingtona, 83, 81000 Podgorica  
Tel.: 00381 81 234 661, 00381 81 234 662  
Fax: 00381 81 234 663

SERBI (*Beograd*)  
Embassy of Italy (Ambasada e Italisë)  
Bircaninova Ulica, 11  
Tel.: 0038111 3066100  
Fax: 3249413

Dr BRANCO VUKMIR, *Hon. Consul*  
Pavlinoviceva Str. 4, 10000 Zagreb  
Tel: 00385 (1) 390 0515  
Fax: 00385 (1) 390 0575  
email: [maltaconsul.zagreb@gov.mt](mailto:maltaconsul.zagreb@gov.mt)

### **3. Imigracioni për qëllime punësimi**

#### **a) kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të punëtorëve të huaj (duke përfshirë llojet e lejeve të punës dhe vizave të punës dhe kriteret, si dhe autoritetet përgjegjëse)**

##### **Lejet e Punës**

##### **Politika e Qeverisë**

Të gjithë shtetasit e huaj kanë nevojë për leje pune për të punuar në Maltë. Përsa i takon të huajve, Qeveria ndjek një politikë kufizuese dhe lejet e punësimit jepen vetëm në raste të veçanta.

Këto leje pune lëshohen për punëdhënësit që dëshirojnë të punësojnë të huaj për një periudhë të caktuar dhe për një qëllim specifik, VETËM pasi të jenë siguruar se është bërë çdo përpjekje e mundshme për të punësuar një shtetas maltez.

##### **Kushtet e lëshimit të lejes**

- a) Aplikantët për leje punësimi duhet fillimisht të sigurojnë një ofertë pune nga një punëdhënës në Maltë;
- b) Aplikantët duhet të kenë një aftësi apo kualifikim të specializuar, për të cilin ka mungesa në Maltë;
- c) Duhet të ketë një kërkesë të madhe në një fushë të caktuar, psh. Infermierë të kualifikuar, udhëzues turistikë që njohin gjuhë të caktuara, punëtorë ndërtimi, etj.

Leja e punës lëshohet nga Drejtoria e Punës pasi janë plotësuar kushtet e mësipërme dhe punëdhënësi i ardhshëm ka paraqitur kërkesë.

##### **Dokumentacioni i nevojshëm**

Dokumentacioni i mëposhtëm duhet të shoqërojë aplikimin tuaj për leje punësimi:

- një pasaportë e vlefshme,
- një vërtetim për sjellje të mirë;
- një letër punësimi që përfshin një përkrahje të plotë detyrash nga punëdhënësi i ardhshëm.

Formulari i aplikimit: [http://www.education.gov.mt/resources/forms/application\\_work%20permit.pdf](http://www.education.gov.mt/resources/forms/application_work%20permit.pdf)

##### **Vlefshmëria & Zgjatja**

Lejet e punësimit janë zakonisht të vlefshme për një vit. Mund të aplikohet gjithashtu për një leje të vlefshme për deri në tre vjet me kërkesën specifike të punëdhënësit dhe me kusht që për këtë të jepen argumente të mjaftueshme. Lejet mund të zgjaten më pas, kur kërkesa për këtë qëllim është e justifikuar.

## **Leja e Qëndrimit**

Leja e qëndrimit jepet automatikisht pas miratimit të lejes së punës për ju dhe bashkëshortin/en tuaj. Megjithatë, kjo nuk i jep të drejtën bashkëshortit/es për të punuar apo për t'u kualifikuar automatikisht për leje pune, me përjashtim të rasteve kur, në këtë fushë, ka kërkesë për punë.

## **Lejet e Pakufizuara**

Në rastet kur një shtetas i huaj është investitor në sektorin e prodhimit apo shërbimeve financiare dhe ka një përqindje të konsiderueshme të aksioneve (40%) në këtë sipërmarrje, leja përkatëse mund të lëshohet për një periudhë të pakufizuar.

### **b) sektorët e tregut të punës që po përjetojnë mungesa**

Shumë punëdhënës po zgjedhin krahun e huaj të punës për shkak të mungesave në shumë sektorë, si psh. turizëm, teknologji informacioni, mjekësi dhe prodhim.

### **c) faqe elektronike për të kërkuar punë**

[www.etc.gov.mt](http://www.etc.gov.mt) – Kjo faqe zyrtare ofron informacion për personat që kërkojnë punë.

[www.eures.com.mt](http://www.eures.com.mt) – Faqja zyrtare e EURES në Maltë

<http://www.jobinmalta.com>

<http://www.prlmalta.com/vacancies.html>

## **4. Imigracioni për qëllime punësimi**

### **a) kushtet e hyrjes dhe qëndrimit për studentët (vizë studenti, leje qëndrimi, e drejta për punë nëse personi e gëzon atë)**

Përveç formularit të aplikimit për vizë, dokumentit të vlefshëm të udhëtimit dhe dy fotografive për pasaportë, aplikanti duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- një biletë të vlefshme kthimi ose një vërtetim të udhëtimit të rezervuar dhe parapaguar,
- provë të fondeve të mjaftueshme
- letër pranimit nga institucioni arsimor që përcakton pranimin dhe detaje për kurset që do të ndiqen,
- rezervimin e hotelit ose konfirmimin nga një ambient ose institucion privat

Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore do t'i verifikojnë këto deklaratë, sipas nevojës.

Keni nevojë gjithashtu për Sigurim Mjekësor dhe Udhëtimi për të mbuluar ndonjë shpenzim që mund të lindë në lidhje me kthimin në atdhe për arsye mjekësore, kujdesin mjekësor urgjent dhe/ose trajtimin spitalor urgjent. Sigurimi duhet të jetë i vlefshëm në të gjitha vendet anëtare të Shengenit dhe duhet të përfshijë të gjithë periudhën e qëndrimit. Shuma minimale që mbulon sigurimi duhet të jetë 30,000 Euro.

### **b) listë e universiteteve dhe kolegjeve kryesore**

**Universiteti i Maltës** (Maltese L-Università ta' Malta)

<http://www.um.edu.mt/> - është institucioni më i lartë arsimor në Maltë. Ai ofron diploma universitare, të cilat zgjasin nga tre deri në pesë vjet dhe diploma pasuniversitare Master që zgjasin dy vjet me kohë të plotë.

**Kolegji Gan Frangisk Abela Junior** <http://www.jc.um.edu.mt/>

### c) programet për studentët e huaj, aty ku gjejnë zbatim

#### **Trainime Praktike për Studentët e Huaj të Shkencave të Natyrës dhe Teknike, Bujqësisë dhe Pyjeve (IAESTE)**

Për afatet e aplikimeve, ju lutemi të kontaktoni me Komitetin Kombëtar të IASTE në Maltë.

IAESTE Malta

c/o Faculty of Engineering

University of Malta

Tel: 00 351 (0) 3290 2106

Fax: 00 351 (0) 343 577

E-Mail: [info@iaeste.org.mt](mailto:info@iaeste.org.mt)

Internet: <http://www.iaeste.org.mt/home.html>

## **5. Qëndrimi**

Lejet e qëndrimit lëshohen për shtetasit e vendeve të treta që janë autorizuar për të qëndruar në Maltë për një qëllim të caktuar. Qëllimi mund të jetë:

- Punësim
- Vetë-punësim
- Të ardhura të mjaftueshme ekonomike
- Pension
- Studim
- Qëndrim afatgjatë
- Arsye të tjera

### **Punësim/ Vetë-punësim / Studim / Arsye Shëndetësore**

Aplikanti duhet të paraqesë dokumentet e nevojshme që mbështesin deklaratat e tij/saj – kopjen e lejes së punës, kopjen e lejes së punës/lejes tregtare për vetë-punësim, vërtetimin e regjistrimit në një institucion të arsimit të lartë për qëllime studimi dhe vërtetimin spitalor ose mjekësor në rastin e arsyeve shëndetësore, ndër dokumentet e tjera, veçanërisht atyre të përcaktuara në vetë formularin e aplikimit.

### **Persona me të ardhura të mjaftueshme ekonomike / Pensionistë**

Në rastin e këtyre personave, leja e qëndrimit do të jepet nëse personi ka, të paktën, një të ardhur minimale vjetore prej 13,976.24 Euro në Maltë. Shuma rritet në 16,305.61 Euro nëse aplikanti është i martuar. Për më tepër, kësaj shume i shtohen 2,329.37 Euro për çdo fëmijë në varësi. Pra, një person i martuar me dy fëmijë – të cilët duhet të jenë **nën** moshën 18 vjeç – duhet të ketë një të ardhur prej 20,964.36 Euro. Duhet vënë re se shumat e treguara më sipër **nuk** përfshijnë shpenzimet për strehim (i cili duhet të jetë në një standard të pranueshëm).

Përveç kësaj, personat që janë në këto kategori duhet të paraqesin prova të sigurimit shëndetësor për veten e tyre dhe pjesëtarët e familjes së tyre, nëse kanë. Edhe personat që kanë një leje qëndrimi të lëshuar nga Komisioneri i Sistemit të Tatimeve (KST) duhet ta përmbushin këtë kriter. Megjithatë, këta të fundit nuk kanë detyrimin për të dorëzuar prova dokumentare për të ardhurat dhe strehimin.

### **Partnerët**

Edhe aplikimet e partnerëve jo-maltezë të shtetasve maltezë ose të shtetasve të vendeve të treta merren në konsideratë, për sa kohë që:

- shtetasi maltez ose shtetasi i vendit të tretë mund të paraqesë prova dokumentare që vërtetojnë të ardhura të rregullta dhe të qëndrueshme prej të paktën 8,665.27 Euro (paga minimale + 20%)
- sigurohen prova dokumentare që partneriteti ka ekzistuar prej të paktën dy vjetësh
- sigurohen prova dokumentare në lidhje me sigurimin shëndetësor për të gjitha rreziqet për të cilat sigurohen zakonisht shtetasit maltezë.

## Arsye humanitare/ Raste të tjera

Nëse sigurohen prova të mjaftueshme që mbështesin pretendimin e aplikantit se kërkesa e tij/saj duhet të shqyrtohet në një aspekt humanitar ose për arsye të tjera, Departamenti do t'i kushtojë kësaj kërkesë vëmendjen e nevojshme. Në rastin e një vendimi pozitiv, aplikantit i lëshohet leje qëndrimi.

## Pjesëtarët e familjes

Shiko seksionin për Bashkimin familjar.

## Statusi i personit me qëndrim afatgjatë

Një person që aplikon për statusin e personit me qëndrim afatgjatë, **duhet** të sigurojë prova dokumentare për:

- qëndrimin e ligjshëm dhe të vazhdueshëm në Maltë për pesë vjet para dorëzimit të aplikimit
- burime të qëndrueshme dhe të rregullta që mjaftojnë për të përballuar shpenzimet e tij/saj dhe të pjesëtarëve të familjes së tij/saj (të barabartë me pagën minimale kombëtare + 20%)
- strehimin që konsiderohet normal për një familje të ngjashme në Maltë dhe që plotëson standardet e përgjithshme të shëndetit dhe të sigurisë që janë në fuqi në Maltë.
- sigurimin shëndetësor për të gjitha rreziqet për të cilat sigurohen zakonisht shtetasit maltezë, për veten e tij/saj dhe pjesëtarët e familjes.

Për më tepër, ata duhet të paraqesin një letër që përshkruan historikun e tyre që kur kanë mbërritur për herë të parë në Maltë. Kjo letër duhet të përmbajë informacion për arsyet për të cilat personat kanë mbërritur dhe kanë qëndruar në Maltë, historikun e punësimit që atëherë, banesën aktuale ose të mëparshme në të cilën ata jetojnë, bashkë me pjesëtarët e familjes nëse jetojnë bashkë në Maltë, si dhe çdo informacion tjetër që mund të jetë i dobishëm gjatë shqyrtimit të kërkesës së tyre për statusin e personit me qëndrim afatgjatë.

Për më shumë informacion, shikoni [http://www.mjha.gov.mt/departments/citizen/urp\\_3cn.pdf.pdf](http://www.mjha.gov.mt/departments/citizen/urp_3cn.pdf.pdf)

Aplikimi për leje qëndrimi, i një shtetasi nga një vend jo-anëtar i BE/ZEE:

- i cili është i punësuar
- i cili është i vetë-punësuar
- i cili studion në një institucion arsimor
- i cili ka të ardhura të mjaftueshme ekonomike
- i cili ka dalë në pension
- i cili ndodhet në Maltë për qëllime të tjera

[http://www.mjha.gov.mt/departments/citizen/cea\\_20.pdf.pdf](http://www.mjha.gov.mt/departments/citizen/cea_20.pdf.pdf)

Department for Citizenship and Expatriate Affairs (Departamenti për Nënshetësinë dhe Çështjet e Shtetasve me Qëndrim në Vend të Huaj)

3, Castille Place

Valletta CMR 02

Nr. i telefonit: 2200 1800

Nr. i faksit: 2200 1830

Adresa e-mail: [citizenship@gov.mt](mailto:citizenship@gov.mt)

## 6. Procedura e Azilit

Të gjitha aplikimet për njohjen e statusit të refugjatit përpunohen dhe vendosen nga Zyra e Komisionerit për Refugjatët.

Një person që kërkon azil në Maltë mund të aplikojë pranë Komisionerit për deklaratë dhe merret në intervistë brenda një jave. Intervista kryhet vetëm për vetëm dhe, sipas nevojës, me ndihmën e një përkthyesi. Komisioneri shqyrton aplikimin për statusin e refugjatit dhe i sugjeron Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Mjedisit pranimin e aplikimit. Nëse Komisioneri sugjeron që aplikimi të pranohet, Ministri përgjegjës për imigracionin, paraqet një deklaratë ku shprehet nëse refugjati i plotëson kriteret ose e kundërshton këtë sugjerim.

Azilkërkuesi lejohet të hyjë dhe të qëndrojë në Maltë derisa të merret vendimi përfundimtar për aplikimin e tij/saj. Ai/ajo do të ketë mundësi të ndjekë shkollimin dhe trainimet shtetërore në Maltë dhe të përfitojë kujdesin mjekësor dhe shërbimet shtetërore. Një azilkërkues nuk mund të kërkojë të punësohet ose të zhvillojë tregti, me përjashtim të

rasteve kur për këtë ka miratimin e Ministrit; ai/ajo duhet të qëndrojë në vendin e caktuar dhe duhet të paraqitet në intervale të përcaktuara pranë autoriteteve të imigracionit.

Azilkërkuesit, të cilëve u është refuzuar aplikimi, kanë të drejtë të bëjnë ankim pranë Bordit të Apelit për sugjerimin negativ; (b) kanë të drejtën të këshillohen me UNHCR dhe të sigurojnë ndihmë ligjore nëpërmjet procedurës së ankimit; dhe (c) në fazën e apelit. Ligji për Refugjatët, i vitit 2000, parashikon se Komisioneri për Refugjatët mund të sugjerojë që, pavarësisht nga fakti nëse personi nuk i plotëson kriteret për t'u njohur si refugjat, atij duhet t'i sigurohet mbrojtje e përkohshme humanitare në Maltë.

## **7. Bashkimi familjar**

Një shtetas i një vendi të tretë ka të drejtë të aplikojë për bashkim familjar sipas kushteve të mëposhtme:

- ai/ajo ka leje qëndrimi të vlefshme për një periudhë minimale prej një viti; dhe
- ajo/ajo ka mundësi të mira që të marrë leje qëndrimi.

Azilkërkuesit dhe personat që qëndrojnë në bazë të mbrojtjes së përkohshme ose ndihmëse, nuk kanë të drejtën e bashkimit familjar.

Pjesëtarët e mëposhtëm të familjes kanë të drejtën e bashkimit familjar:

- bashkëshorti/ja (të paktën 21 vjeç)
- fëmijët e mitur të pamartuar, duke përfshirë fëmijët e birësuar në një mënyrë që njihet nga ligji maltez;

Aplikimi për hyrje dhe qëndrim i paraqitet Drejtorit të Departamentit për Nënshetësinë dhe Çështjet e Shtetasve me Qëndrim në Vend të Huaj, në Ministrinë e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme nga personi që ka leje qëndrimi.

Pjesëtarëve të familjes mund t'u lëshohet një leje e parë qëndrimi me kohëzgjatje të paktën një vit, e cila mund të zgjatet me kusht që kohëzgjatja e lejeve të qëndrimit që u jepen pjesëtarëve të familjes, në parim, nuk e kalon datën e përfundimit të afatit të lejes origjinale të qëndrimit. Sponsorit dhe pjesëtarëve të familjes mund t'u kërkohet të ndjekin dhe përfundojnë me sukses një kurs në gjuhën malteze.

Pjesëtarët e familjes së sponsorit kanë të drejtën, njëjloj si sponsori:

- për të ndjekur shkollim;
- për t'u punësuar dhe për të kryer aktivitetet vetë-punësues, në rast se përmbushin kriterin e lejes së punës për vitin e parë (që i nënshtrohet vlerësimit të tregut të punës)
- për të marrë udhëzime profesionale, trainim dhe ri-trainim fillestar dhe të mëtejshëm.

Me përfundimin e periudhës pesë-vjeçare të qëndrimit në Maltë dhe nëse pjesëtari i familjes nuk ka marrë ende leje qëndrimi për arsye të tjera nga ato të bashkimit familjar, bashkëshorti/ja ose fëmija që ka arritur moshën madhore, ka të drejtën të kërkojë dhe të marrë leje qëndrimi autonome.

Formulari i aplikimit [http://www.mjha.gov.mt/departments/citizen/cea\\_23.pdf.pdf](http://www.mjha.gov.mt/departments/citizen/cea_23.pdf.pdf)

## **8. Sistemi i Kujdesit Shëndetësor**

Në Maltë, Qeveria ofron shërbim mjekësor gjithëpërfshirës falas për të gjithë banorët. Ky shërbim shëndetësor financohet nga taksat e përgjithshme. Të gjithë banorët mund të përfitojnë shërbimet parandaluese, verifikuese, kuruese dhe rehabilituese në Qendrat dhe Spitalet Shëndetësore Shtetërore. Personat me të ardhura të ulëta i nënshtrohen një "testi për të ardhurat" nga Departamenti i Sigurimit Shoqëror. Nëse ata kualifikohen për ndihmë, ata marrin një kartë e cila i mundëson të marrin mjekime falas. Përveç kësaj, një person që vuan nga një apo më shumë sëmundje kronike që i përkasin një liste specifike (psh. artrit reumatizmal) përfitojnë trajtim falas për sëmundjen e tyre, pavarësisht nga mjetet financiare që disponojnë.

Qeveria ofron kujdes shëndetësor parësor kryesisht nëpërmjet tetë Qendrave Shëndetësore që sigurojnë një shkallë të gjerë shërbimesh parandaluese, kuruese dhe rehabilituese. Shërbimet e infermierisë dhe mamive ofrohen nga Shoqata Malteze e Infermierisë Memoriale të Rajonit (SMIMR) mbi bazë kontratash.

Sistemi i Qendrave Shëndetësore Shtetërore funksionon përkrah një sektori privat të lulëzuar dhe mjaft nga banorët zgjedhin shërbimet e mjekëve të përgjithshëm dhe të specializuar privatë të cilët punojnë në fushën e kujdesit parësor.

Në të gjithë ishujt ka mjaft farmaci dhe farmacistë, megjithëse nuk ka një simbol nëpërmjet të cilëve ata mund të dallohen. Ata punojnë me orarin e zakonshëm nga ora 8:30 ose 09:00 deri në orën 13:00 dhe më pas nga ora 16:00 deri në 19:00.

## 9. Sistemi i sigurimit shoqëror

Sistemi aktual i përkrahjes sociale në Maltë është rezultat i zhvillimit të një pakete ligjesh gjatë disa dekadave. Kontributet dhe përfitimet e sigurimeve shtetërore janë thelbi i përkrahjes sociale, që synon të reduktojë vështirësitë financiare të sëmundjeve, aftësive të kufizuara, lëndimeve, moshës së vjetër dhe papunësisë.

Përkrahja sociale në Maltë jepet nga Departamenti i Sigurimit Shoqëror me qendër në Valeta. Sigurimi shtetëror mbledhet nga departamenti i tatimeve, por fondi administrohet nga autoritetet e sigurimit shoqëror. Edhe njësitë e shëndetësisë dhe strehimit luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e kujdesit mjekësor dhe mbështetjes për strehimin.

Departamenti i sigurimit shoqëror aktualisht ndahet në pesë degë kryesore:

- Njësia e Përfitimeve të Kontributeve
- Njësia e Përfitimeve jo-të Kontributeve
- Drejtoria e Hetimeve për Mashtrimet e Përfitimeve
- Kujdesi për Klientin & Marrëdhëniet Ndërkombëtare
- Financa & Administrata

Departamenti ofron ndihmë për kërkesat për çdo lloj ndihme si dhe siguron këshilla dhe informacion të përgjithshëm. Vlerësimi aktual i kërkesave për pjesën më të madhe të ndihmave dhe administrimi i përgjithshëm i organizatës kryhet nga zyrat qendrore të departamentit.

Social Security Department (Departamenti i Sigurimit Shoqëror)  
38 Ordinance Street,  
Valletta - CMR 02.  
Telefon: 25903000  
Fax: 25903001

## 10. Strehimi

Ambientet që jepen me qira janë kryesisht pronë private. Nëse kërkoni banesë, ka agjentë të pronave të patundshme të specializuar për banesat me qira. Gazetat lokale kanë mjaft njoftime për dhënie me qira çdo ditë. Ka gjithashtu gazeta javore të cilat botojnë njoftime që vendosen nga pronarët që kërkojnë qiramarrës të mundshëm.

Edhe mundësitë e kërkimit në internet janë duke u rritur. Agjentët kryesorë të pronave kanë një seksion për banesat që jepen me qira në faqet e tyre elektronike.

Kontratat e qiradhënies zakonisht janë pesëvjeçare, deri në një periudhë maksimale prej 10 vjetësh. Megjithatë, këto mund të ulen në tre vjet ose sipas negociimit me pronarët. Pagesa e shërbimit të agjentëve është 10% e vitit të parë të qirasë plus TVSH.

## 11. Njohja e diplomave

Malta është anëtare e ENIC-NARIC (Qendrave Kombëtare të Informacionit për Njohjen Akademike, [www.enic-naric.net](http://www.enic-naric.net)), që është një rrjet i qendrave kombëtare i cili synon të përmirësojë njohjen akademike të diplomave dhe periudhës së studimit në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), vendet e ZEE-së dhe vendeve partnere të Evropës Qendrore dhe Lindore. Malta-NARIC ([www.education.gov.mt](http://www.education.gov.mt)) gjithashtu synon të ofrojë informacion dhe këshilla në konsultim me organe të tjera për ekuivalentimin e kualifikimeve ndërkombëtare me ato malteze.

Malta Qualification Recognition Information Centre (Malta QRIC) (Qendra Malteze e Informacionit për Njohjen e Kualifikimeve)  
Ministry of Education (Ministria e Arsimit)  
Room No 328  
Great Siege Road  
Floriana  
Tel: +356 21 240419  
Fax: +356 21 239842  
E-mail: [qric.malta@gov.mt](mailto:qric.malta@gov.mt)

Formulari i aplikimit: [http://www.education.gov.mt/edu/assess\\_qualification\\_form.pdf](http://www.education.gov.mt/edu/assess_qualification_form.pdf)

## **12. Shërbimet mbështetëse që u ofrohen migrantëve nga institucionet publike, OJF-të, sindikatat, linjat telefonike**

**Programi i Dhunës në Familje i Kontesë Phillips (Malta)** - + (406) 654-2090/Nr. telefonit 654-1100

### **SOS Malta**

[www.sosmalta.org](http://www.sosmalta.org)

SOS Malta, një OJF malteze e regjistruar, e cila është themeluar në vitin 1991, synon të ndihmojë personat që përjetojnë periudha krizash dhe t'i fuqizojë ata duke i siguruar shërbime mbështetjeje dhe mundësinë për të zbatuar rastet për zhvillim dhe ndryshim në vendin e tyre me qëllim për të siguruar një cilësi më të mirë jete.

Zyra e Valetës:

Adresa: Dar L-Emigrant, Castille Place

Qyteti: Valletta

Kodi postar: VLT01

Telefoni: +356 21240255

Fax: +356 21240022

Email: [info@sosmalta.org](mailto:info@sosmalta.org)

### **Rrjeti Maltez i Mbështetjes për Shtetasit e Vendeve të Treta (TSN Malta)**

është një organizatë jo-fitimprurëse që përqendrohet në reduktimin e dallimeve ndërmjet të sapoardhurve, grupeve ndër-kulturore dhe shoqërisë tradicionale në Maltë nëpërmjet informacionit, arsimit dhe trainimit. Ata ofrojnë një shumëllojshmëri shërbimesh që i ndihmojnë imigrantët të integrohen në shoqërinë malteze dhe shtetasit maltezë të mësojnë më shumë për diversitetin kulturor dhe ta vlerësojnë atë.

Tel: + 356 21244123

e-mail: [tsn@mrc.org.mt](mailto:tsn@mrc.org.mt)

[www.mrc.org.mt](http://www.mrc.org.mt)

### **Shërbimi Maltez Jezuit për Refugjatët**

<http://www.jrsmalta.org/>

SJR Malta i shërben dhe bën lobing për të drejtat e refugjatëve, azilkërkuesve dhe personave të zhvendosur me forcë që ndodhen në Maltë.

Email: [info@jrsmalta.org](mailto:info@jrsmalta.org)

## **13. Marrja e nënshtetësisë**

Në Maltë lejohet dyshtetësia.

Fëmijët e shtetasve maltezë e marrin shtetësinë malteze që **nga lindja**.

### **Nëpërmjet martesës**

Bashkëshorti/ja i/e huaj i/e një shtetasi maltez mund të marrë nënshtetësinë malteze nëpërmjet martesës pas pesë vjetësh martese. Qëndrimi në Maltë nuk është i nevojshëm.

- Vejanët/vejushat e një shtetasi/e maltez/e (kur bashkëshorti/ja ka vdekur brenda pesë viteve të para të martesës) mund të aplikojnë për nënshtetësi malteze mbi bazën e martesës, 5 vjet nga data e martesës me bashkëshortin/en e ndjerë.
- Personat e ndarë nga një bashkëshort/e malteze mund gjithësesi të aplikojnë për nënshtetësinë malteze me kusht që të kenë jetuar bashkë për pesë vjet

## Nëpërmjet regjistrimit

Mbi bazën e shtesave dhe ndryshimeve që iu bënë Ligjit për Nënshtetësinë në Maltë, i cili hyri në fuqi më 1 gusht 2007, tani është e mundur që të gjithë personat me orgjinë malteze të marrin nënshtetësinë malteze mbi bazën e regjistrimit.

Personi duhet vetëm të sigurojë prova dokumentare si psh. certifikatë lindjeje, martese ose vdekjeje për t'u regjistruar si shtetas. Ky dokumentacion duhet të tregojë prejardhjen e drejtpërdrejtë nga një paraardhës i lindur në Maltë nga një prind që ka lindur gjithashtu në Maltë. Nëse personi ka prindër, gjyshër, etj. që janë gjallë dhe janë gjithashtu pasardhës të drejtpërdrejtë, ato duhet të paraqesin aplikim (linja e drejtpërdrejtë nuk mund të kalojë).

Nënshtetësia malteze mund të sigurohet edhe nëpërmjet natyralizimit, nëse:

- Jeni ish-shtetas i Maltës;
- Keni lindur jashtë nga prindër maltezë të cilët janë migrantë të kthyer;
- Keni lindur në Maltë, keni një shtetësi të huaj dhe të paktën njëri prej prindërve tuaj është një shtetas maltez;
- Keni lindur nga prindër të cilët nuk ishin maltezë, por njëri prej tyre ose të dy më pas kanë marrë shtetësinë malteze;
- Keni lindur jashtë dhe keni prejardhje malteze.

Është gjithashtu e mundur 'të plotësosh kriteret' për të marrë shtetësinë malteze nëpërmjet natyralizimit pas pesë vjetësh qëndrimi të ligjshëm në Maltë. Në praktikë, aplikimet marrin përgjigje pozitive vetëm kur personat kanë lindur në Maltë, kanë qëndruar aty për më shumë se 18 vjet, kanë një prind maltez ose për arsye humanitare.

Për më shumë informacion, mund të kontaktoni:

The Department for Citizenship and Expatriate Affairs, 3, Castille Place, Valletta, tel. 356/250868;

Numri telefonik falas: 0800772258

e-mail: [citizenship@gov.mt](mailto:citizenship@gov.mt).

<http://www.mjha.gov.mt/departments/citizen/forms.html>

## 14. Kontakte dhe informacion tjetër i nevojshëm

Ministria e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme

<http://www.mha.gov.mt/home.html>

Ministria e Punëve të Jashtme

<http://www.foreign.gov.mt>

Ministria e Politikave Sociale

<http://www.msp.gov.mt>

Ministria e Arsimit

<http://www.education.gov.mt>